



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 10, DATË 15/ 07/ 2025

PËR

MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “KAMPINGU PA EMËR – GURI I LËMUAR” ME
SUBJEKT APLIKUES “KAMPING ‘PA EMËR’ PEPOSHI KARPEN-KAVAJË”
SHPK ME NUIS K72701801L

Në mbështetje të neneve 8, 9, 13 dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut I, pika 3/c të VKM-së Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Subjekti “Kamping ‘Pa Emër Peposhi’ Karpen-Kavajë sh.p.k.”, është trajtuar me dy vendime të mëparshme për mospranimin e kërkesës nga Komiteti i Investimeve Strategjike.
- Projekti “Kampingu pa emër – Guri Lëmuar” synon ndërtimin e një agroturizmi dhe kampingu me vila druri, vende kamperash dhe tendash në ZK 2909, në Gurin e Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë.
- Projekti synon të realizohet nga subjekti “Kamping ‘Pa Emër’ Peposhi Karpen-Kavajë” sh.p.k. me NUIS K72701801L.
- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 5,200,000 (pesë milion e dyqind mijë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 80 (tetëdhjetë) persona.

- Subjekti kërkon si masë mbështetëse dhënien e së drejtës së përdorimit të pasurisë të paluajtshme shtetërore, pjesë e pasurisë nr. 106/22 në ZK 2909, me sipërfaqe 9.9 Ha.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Kamping Pa Emër- Guri Lëmuar”, me subjekt investues “Kamping ‘Pa Emër’ Peposhi Karpen-Kavajë” sh.p.k. me NUIS K72701801L, Guri i Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti i propozuar nuk përputhet me vizionin dhe strategjinë aktuale të zhvillimit për zonën e interesit. Në këtë zonë, qeveria dhe institucionet përkatëse kanë ndërmarrë dhe harmonizuar një sërë nismash dhe planesh strategjike, të cilat synojnë një zhvillim specifik dhe afatgjatë. Projekti i paraqitur nuk gjen koherencë me këto prioritetë dhe drejtime të përcaktuara zhvillimore, duke mos u integruar në mënyrë optimale në kuadrin ekzistues.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)